



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-04

Prokurori kundër Pjetër Shalës

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 11 gusht 2022

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Version i Redaktuar Publik i Vendimit të Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtjes së Pjetër Shalës

Zhan-Lui Zhilisen

Zyrës së Pjesëmarrjes së Viktimave

Ushtrueses së detyrës së shefit të Zyrës
së Pjesëmarrjes së Viktimave

Mbrojtësit të Viktimave

Sajmon Loz

I. HISTORIKU PROCEDURAL	2
II. PARASHTRIME	3
III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE	4
A. Parashtrimi i kërkesës dhe pranimi në proces	4
B. Pjesëmarrja në procedurën paraprake	5
C. Masat mbrojtëse.....	6
IV. DISKUTIM	7
A. Vlerësimi i Kërkesës.....	8
1. Plotësia e kërkesave	8
2. Pranueshmëria e kërkesës	8
3. Përfundim	9
B. Masat mbrojtëse.....	10
C. Grupimi dhe përfaqësimi juridik i përbashkët	13
D. Pjesëmarrja në procedurën paraprake	14
V. VENDIM	14

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të neneve 22 dhe 39(11) dhe (13) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullave 80, 95(2)(h) dhe (i), 113 dhe 114 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), nxjerr këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 19 qershor 2020, në vijim të vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake,² Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) dorëzoi Aktakuzën e Konfirmuar kundër Pjetër Shalës (“z. Shala” ose “i akuzuari”).³
2. Më 1 shtator 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori “Vendimin Kornizë mbi Parashtrimin e Kërkesave nga Viktimat” (“Vendimi Kornizë”),⁴ duke urdhëruar, ndër të tjera, Zyrën e Pjesëmarrjes së Viktimave (“ZPV”) që t’u dorëzonte Gjykatësit të Procedurës Paraprake dhe palëve, jo më vonë se 1 tetor 2021, raportin e vet të parë sipas rregullës 113(2) të Rregullores në lidhje me kërkesat e parashtruara dhe që të parashtronte në intervale të rregullta raporte të mëtejshme, nëse do të kishte, dhe më

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-04, F00007, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Konfirmimin e Aktakuzës kundër Pjetër Shalës* (“Vendimi i Konfirmimit”), 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar konfidencial dhe versioni i redaktuar publik u lëshuan më 6 maj 2021, F00007/CONF/RED dhe F00007/RED.

³ KSC-BC-2020-04, F00010, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar*, 19 qershor 2020, publik, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcën 2, konfidenciale. Versioni i redaktuar me më pak redaktime dhe versioni publik me redaktime të mëtejshme i Aktakuzës së Konfirmuar u dorëzuan më 31 mars 2021, F00016/A01 dhe F00016/A02. Versioni konfidencial me më pak redaktime i Aktakuzës së Konfirmuar u dorëzua më 25 maj 2021, F00038/A01. Pas Vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake në lidhje me Mocionin e Mbrojtjes që për mangësi në formën e Aktakuzës së Konfirmuar, aktakuza e korrigjuar u dorëzua më 1 nëntor 2021, F00098/A01, konfidencial. Versioni i redaktuar publik i aktakuzës së korrigjuar u dorëzua më 16 nëntor 2021, F00107/A01.

⁴ KSC-BC-2020-04, F00064, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim Kornizë mbi Parashtrimin e Kërkesave nga Viktimat*, 1 shtator 2021, publik.

së voni dy javë para dorëzimit të parashtrimit të Mbrojtjes sipas rregullës 95(5) të Rregullores.⁵

3. Më 15 dhjetor 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori vendimin e parë mbi pjesëmarrjen e viktimave, duke pranuar një viktimë si pjesëmarrëse në proces (“Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave”).⁶

4. Më 21 korrik 2022, ZPV-ja dorëzoi raportin e dytë për kërkesat e viktimave për pjesëmarrje në proces, me të cilin paraqiti një kërkesë të mëtejshme të një personi, viktima 02/04 (“parashtruesi i kërkesës”), dhe ofroi rekomandime lidhur me pranueshmërinë, grupimin, përfaqësimin e përbashkët dhe masat mbrojtëse (“Raporti i Dytë i Zyrës Administrative”).⁷

5. ZPS-ja dhe Mbrojtja e z. Shala (“Mbrojtja”) nuk paraqitën përgjigje ndaj Raportit të Dytë të Zyrës Administrative.

II. PARASHTRIME

6. ZPV-ja vlerëson se kërkesa është e plotë dhe e pranueshme dhe i rekomandon Gjykatësit të Procedurës Paraprake që të pranojë parashtruesin e kërkesës si viktimë pjesëmarrëse.⁸ Ajo gjithashtu rekomandon që parashtruesi i kërkesës të grupohet me viktimën tashmë të pranuar për përfaqësim juridik të përbashkët dhe të përfaqësohen prej mbrojtësit të viktimave të caktuar.⁹ Së fundi, ZPV-ja propozon që parashtruesit të kërkesës t’i caktohet një pseudonim dhe t’i jepet

⁵ Vendimi Kornizë, para.21, 30, 32, 63(c)-(e).

⁶ KSC-BC-2020-04, F00123, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave*, 15 dhjetor 2021, konfidencial, para. 50(a). Versioni i redaktuar publik u nxor më të njëjtën ditë, F00123/RED.

⁷ KSC-BC-2020-04, F00236, ZPV, *Raporti i Dytë i Zyrës Administrative drejtuar Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi Kërkesat e Viktimave për Pjesëmarrje në Proces*, 21 korrik 2022, publik, para.2, 29 [sic], 34, 36, 42, me një Shtojcë, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

⁸ Raporti i Dytë i Zyrës Administrative, para. 15, 29 [sic].

⁹ Raporti i Dytë i Zyrës Administrative, para. 34, 36.

anonimitet në lidhje me publikun, të akuzuarin dhe mbrojtësit për të garantuar mbrojtjen e tij.¹⁰

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

A. PARASHTRIMI I KËRKESËS DHE PRANIMI NË PROCES

7. Në pajtim me nenin 22(1) të Ligjit dhe rregullën 2 të Rregullores, viktimë është personi fizik që ka pësuar personalisht dëm fizik, mendor ose material si pasojë e drejtpërdrejt e një vepre penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara (“DHS”) dhe që pretendohet në një aktakuzë të konfirmuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake .

8. Në pajtim me rregullën 113(1) të Rregullores, pas konfirmimit të një aktakuze dhe në kohë të mjaftueshme përpara hapjes së çështjes, një person që pretendon se është viktimë e një vepre penale të pretenduar në aktakuzë, mund të bëjë kërkesë për praninë si viktimë pjesëmarrëse në proces, në të cilën saktëson se si i përmbush kriteret si viktimë dhe jep vendin dhe datën e veprës penale që pretendohet se ka shkaktuar dëm. Formularët e kërkesave nuk u bëhen të njohura palëve.

9. Në pajtim me rregullën 113(2) të Rregullores, ZPV-ja regjistron dhe vlerëson kërkesat dhe ia dorëzon Gjykatësit të Procedurës Paraprake, së bashku me një rekomandim për pranueshmërinë dhe përfaqësimin e përbashkët, si dhe një kërkesë për masa mbrojtëse sipas rregullës 80 të Rregullores, sipas rastit. ZPV-ja gjithashtu duhet t’u parashtojë palëve një raport konfidencial, pa zbuluar të dhënat identifikuese të parashtruesve të kërkesave.

10. Në pajtim me rregullën 95(2)(i) dhe 113(4)-(5) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka dhënë prova *prima*

¹⁰ Raporti i Dytë i Zyrës Administrative, para. 42

facie për dëmin e pësuar si pasojë e drejtpërdrejt e një veprë penale të përfshirë në aktakuzë dhe nxjerr një vendim të arsyetuar me anë të të cilit miraton ose refuzon pranimin në proces. Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu vendos në lidhje me përfaqësimin e përbashkët dhe çfarëdo kërkesë për masa mbrojtëse. Vendimi u njoftohet parashtruesit të kërkesës, ZPV-së dhe palëve.

11. Në pajtim me rregullën 113(6) të Rregullores, personat të cilëve u refuzohet kërkesa kanë të drejtën e apelimit të vendimit brenda katërbëdhjetë (14) ditësh nga njoftimi i vendimit për refuzim të pranimit në një gjuhë që e kuptojnë.¹¹

12. Në pajtim me rregullën 113(8) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, pasi konsultohet me ZPV-në, vendos nëse viktimat pjesëmarrëse në proces të ndahen në grupe me përfaqësim të përbashkët, duke marrë parasysh:
(a) konfliktet e interesave që mund të pengojnë përfaqësimin e përbashkët;
(b) interesat e ngjashme që mund të mundësojnë përfaqësimin e përbashkët; dhe
(c) të drejtat e të akuzuarit dhe interesat e një gjykimi të drejtë dhe të shpejtë.

B. PJESËMARRJA NË PROCEDURËN PARAPRAKE

13. Në pajtim me nenin 22(3) të Ligjit, interesi personal dhe e drejta e një viktime në procedurën penale para Dhomave të Specializuara janë njoftimi, pranimi dhe zhdëmtimi.

14. Në pajtim me rregullën 113(7) të Rregullores, kur viktimave u miratohet e drejta e pjesëmarrjes në proces, Administratori cakton një mbrojtës të viktimave në përputhje me Direktivën për Mbrojtësit.

15. Në pajtim me nenin 22(6) të Ligjit dhe rregullën 114(1) të Rregullores, viktimat pjesëmarrëse në proces ushtrojnë të drejtat e tyre përmes një mbrojtësi të

¹¹ *Shih gjithashtu KSC-BC-2020-06, IA005/F00003, Gjykata e Apelit, Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes për Sqarim dhe Ndryshim të Afatit, 31 maj 2021, publik, f. 3.*

viktimave të caktuar, ndër të tjera, gjatë procedurës paraprake, kur preken interesat e tyre dhe vetëm kur kjo nuk cenon ose nuk bie ndesh me të drejtat e të akuzuarit.

16. Në pajtim me rregullën 114(4) të Rregullores, nëse është e nevojshme dhe varësisht nga rrethanat, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxjerr udhëzime të posaçme që rregullojnë pjesëmarrjen e viktimave në procedurën paraprake, në pajtim me nenin 22(3) dhe (6) të Ligjit.

17. Në pajtim me rregullën 114(2) të Rregullores, mbrojtësi i viktimave mund të jetë i pranishëm në procedurën paraprake nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake e gjykon të arsyeshme, me qëllim garantimin e interesave personale dhe të drejtën e viktimave pjesëmarrëse në proces, në përputhje me nenin 22(3) të Ligjit.

18. Në pajtim me rregullën 114(3) të Rregullores, mbrojtësi i viktimave ka qasje në materiale konfidenciale, përveç nëse Rregullorja parashikon ndryshe ose sipas vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake. Mbrojtësi i viktimave i informon rregullisht klientët për zhvillimet përkatëse në lidhje me çështjen gjyqësore, në një mënyrë që nuk zbulon informacione konfidenciale.

19. Në pajtim me rregullën 114(4) të Rregullores, kurdoherë që preken interesat personale të viktimave pjesëmarrëse në proces, dhe nëse nuk parashikohet në Rregullore, mbrojtësi i viktimave, nën mbikëqyrjen e trupit gjykues, bën parashtrime gojore ose me shkrim.

C. MASAT MBROJTËSE

20. Në pajtim me nenin 39(11) të Ligjit dhe rregullën 95(2)(h) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, kur është e nevojshme, mund të marrë vendime mbi mocionet në lidhje me mbrojtjen dhe jetën private të viktimave dhe të dëshmitarëve, të protokolluara para kalimit të dosjes gjyqësore trupit gjykues.

21. Në pajtim me rregullën 80(1) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *proprio motu* ose me kërkesë, mund të urdhërojë masa mbrojtëse për mbrojtjen, sigurinë dhe mirëqenien fizike dhe mendore, dinjitetin dhe privatësinë, ndër të tjera, të viktimave pjesëmarrëse në proces.

22. Në pajtim me rregullën 80(4) të Rregullores, masa të tilla mund të përfshijnë mosnxjerrjen për palët të materialit apo informacionit që mund të çojë në zbulimin e identitetit të viktimës pjesëmarrëse në proces.

IV. DISKUTIM

23. Gjatë vlerësimit të kërkesës së parashtruesit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake udhëhiqet nga parimet e përcaktuara në Vendimin Kornizë dhe Vendimin e Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave në lidhje me kriteret që një kërkesë të konsiderohet e plotë,¹² kriteret e pranueshmërisë,¹³ standardin e vërtetimit,¹⁴ kriteret ligjore që zbatohen për miratimin e masave mbrojtëse¹⁵ dhe kriteret për ndarje në grupe të viktimave për përfaqësimin e përbashkët ligjor.¹⁶

¹² Vendimi Kornizë, para. 24.

¹³ Vendimi Kornizë, para. 34, 36-45; Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 28-33.

¹⁴ Vendimi Kornizë, para. 35.

¹⁵ Vendimi Kornizë, para. 52-56; KSC-BC-2020-06, F00817, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave*, 25 maj 2022, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 36-40, 42. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, F00817/RED.

¹⁶ Vendimi Kornizë, para. 48-51 (*Shih gjithashtu* para. 33, 46-47, 51, dhe 56 lidhur me rolin e ZPV-së në kryerjen e vlerësimit paraprak për pranueshmëri, grupim dhe masa mbrojtëse).

A. VLERËSIMI I KËRKESËS

1. Plotësia e kërkesave

24. Pas shqyrtimit të formularëve të kërkesave dhe dokumentacionit mbështetës sipas kriterëve të përcaktuara në Vendimin Kornizë,¹⁷ Gjykatësi i Procedurës Paraprake bindet se kërkesa është e plotë.¹⁸

2. Pranueshmëria e kërkesës

25. *Person fizik.* Gjykatësi i Procedurës Paraprake bindet se parashtruesi i kërkesës ka paraqitur dëshmi të mjaftueshme identiteti dhe është person fizik.¹⁹

26. *Krimet e pretenduara.* Gjykatësi i Procedurës Paraprake bindet se parashtruesi i kërkesës është viktimë jo e drejtpërdrejt e krimeve (ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë) që pretendohet se janë kryer në Fabrikën e Metalit në Kukës, Shqipëri, që prej 17 majit 1999, ose rreth kësaj date deri më 5 qershor 1999, ose rreth kësaj date²⁰ kundër një anëtari të familjes së ngushtë i cili përmendet në Aktakuzën e Konfirmuar.²¹ Ndonëse, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka mundësinë, në këtë rast, që të vlerësojë pranueshmërinë e kërkesës së bashku me Aktakuzën e Konfirmuar, ZPV-së i sillet në vëmendje që t'i këshillojë parashtruesit

¹⁷ Vendimi Kornizë, para. 24.

¹⁸ Raporti i Dytë i Zyrës Administrative, para. 15. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se, megjithëse parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur dokumentacionin në lidhje me dëmin e pësuar, përshkrimi i hollësishëm i parashtruesit të kërkesës ka qenë i mjaftueshëm për të arritur në konstatimet përkatëse.

¹⁹ Raporti i Dytë i Zyrës Administrative, para. 19; Viktima 02/04, Formulari i Kërkesës f. 1; SD1-Pasaport; SD4-Certifikatë Lindjeje.

²⁰ [REDAKTUAR]. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konsideron se referencat në paragrafët në Aktakuzën e Konfirmuar mund të çojnë në identifikimin e viktimës 02/04; *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-04, F00037/A02, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 2 e Parashtrimit të Përmbledhjes sipas Rregullës 86(3)(b) të Korrigjuar*, 19 maj 2021, konfidenciale, *për shembull*, f. [REDAKTUAR]. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, F00037/A03; Vendimi i Konfirmimit, para. [REDAKTUAR].

²¹ Raporti i Dytë i Zyrës Administrative, para. 20-22; Shtojcë e Raportit të Dytë të Zyrës Administrative; Viktima 02/04, Formulari i Kërkesës; Aktakuza e Konfirmuar. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konsideron se referencat në paragrafët në Aktakuzën e Konfirmuar mund të çojnë në identifikimin e viktimës 02/04.

e kërkesave që në formularin e kërkesës të shtojnë të gjithë informacionin e nevojshëm dhe t'u rikthehet parashtruesve për të kërkuar informacion shtesë me qëllim kompletimin e kërkesës, në qoftë se është e nevojshme,²² dhe të paraqesin të gjitha dokumentet mbështetëse përkatëse.²³ Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron ZPV-në që të paraqesë kopje të shënimit në dosje që përmendet në Shtojcën e Raportit të Dytë të Zyrës Administrative, jo më vonë se të premtën, 19 gusht 2022.

27. *Dëmi.* Gjykatësi i Procedurës Paraprake bindet se parashtruesi i kërkesës, anëtarë i familjes së ngushtë të viktimës së drejtpërdrejtë, ka pësuar personalisht dëm mendor (stres dhe pikëllim) si pasojë e drejtpërdrejtë e ndalimit arbitrar të pretenduar, trajtimit mizor dhe torturës që pretendohet të ketë pësuar viktimja e drejtpërdrejtë.²⁴ Në lidhje me pretendimet e parashtruesit të kërkesës se ai ka pësuar dëm material, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vlerëson se nuk ka informacion të mjaftueshëm për konstatim *prima facie* se parashtruesi i kërkesës ka pësuar edhe dëm material si pasojë e drejtpërdrejtë e krimeve të paraqitura në Aktakuzë.²⁵

28. Konstatimet e mësipërme nuk cenojnë asnjë vendim të ardhshëm pas dorëzimit të materialit shtesë.

3. Përfundim

29. Bazuar në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se ka prova *prima facie* se parashtruesi i kërkesës ka pësuar dëm si pasojë e drejtpërdrejtë e

²² *Shih gjithashtu* Vendimi Kornizë, para. 22 dhe 24 (“(iv) data/periudha dhe vendndodhja e krimit, si dhe dëmi i pësuar janë shënuar mjaftueshmërisht qartë”).

²³ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se ndërsa poshtëshënimi 3 në Shtojcën e Raportit të Dytë të Zyrës Administrative përmend shënimin në dosje, ky dokument mbështetës nuk është shtuar, dhe nuk është i disponueshëm në *Legal Workflow*.

²⁴ Raporti i Dytë i Zyrës Administrative, para. 23-28; Shtojca e Raportit të Dytë të Zyrës Administrative; Viktima 02/04, Formulari i Kërkesës; SD2-Certifikatë lindjeje; SD4- Certifikatë lindjeje.

²⁵ Raporti i Dytë i Zyrës Administrative, para. 29; Shtojca e Raportit të Dytë të Zyrës Administrative; Viktima 02/04, Formulari i Kërkesës.

krimeve të pretenduara në Aktakuzën e Konfirmuar dhe pranon parashtruesin e kërkesës si viktimë pjesëmarrëse në proces.

B. MASAT MBROJTËSE

30. ZPV-ja rekomandon që parashtruesit të kërkesës t'i caktohet pseudonim dhe të miratohet moszbulimi i identitetit të tij për publikun, të akuzuarin dhe mbrojtësin.²⁶

31. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se, sikurse theksohet në Vendimin Kornizë, kriteri ligjor që zbatohet për masat mbrojtëse në lidhje me viktimat është i njëjti kusht që zbatohet në lidhje me dëshmitarët.²⁷

32. Për vlerësimin e ekzistencës së rrezikut objektivisht të arsyeshëm dhe domosdoshmërisë së masave mbrojtëse, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mban parasysh faktorët në vijim: (i) parashtruesi i kërkesës pretendon se ai vuan [REDAKTUAR]; dhe (ii) parashtruesi i kërkesës ka [REDAKTUAR].²⁸ Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake u kushton vëmendje: (i) atmosferës së përgjithshme të frikësimit të dëshmitarëve dhe viktimave që mbizotëron në Kosovë, veçanërisht në proceset penale kundër ish-ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës;²⁹ dhe (ii) ekziston rreziku që i akuzuari të pengojë ecurinë e procesit të DHS-së dhe/ose të kryejë vepra të tjera penale, duke marrë parasysh

²⁶ Raporti i Dytë i Zyrës Administrative, para. 42.

²⁷ Vendimi Kornizë, para. 54; Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 36.

²⁸ Viktima 02/04, Formulari i Kërkesës, f. 2. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se viktima 02/04 nuk ka shprehur shqetësime në lidhje me zbulimin e identitetit të tij për palët.

²⁹ KSC-BC-2020-04, F00045, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Pjetër Shalës për Lirim të Përkohshëm* ("Vendimi mbi Lirimin e Përkohshëm"), 15 qershor 2021, konfidencial, para. 26. Versioni i redaktuar publik i lëshua më 23 qershor 2021, F00045/RED; F00224, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Pjetër Shalës* ("Vendimi mbi Rishikimin e Paraburgimit"), 22 qershor 2022, konfidencial, para. 30. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, F00224/RED,

[REDAKTUAR].³⁰ Për më tepër, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu ka parasysh se masat mbrojtëse përkatëse për një viktimë shpesh janë mjete juridik përmes të cilit mund të sigurohet pjesëmarrja e tyre në proces dhe këto masa janë një hap i domosdoshëm për mbrojtjen e sigurisë, mirëqenies fizike dhe psikologjike, dinjiteti dhe privatësisë së tyre në përputhje me rregullën 80 të Rregullores.³¹

33. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se viktima 02/04 nuk ka kërkuar moszbulimin e identitetit të tij për të akuzuarin dhe Mbrojtjen.³² Gjykatësi i Procedurës Paraprake megjithatë vëren se familjarët e viktimës 02/04 kanë shprehur interesim për parashtrim të kërkesës si viktima pjesëmarrje në proces.³³ Rrjedhimisht, zbulimi i identitetit të viktimës 02/04 për të akuzuarin dhe Mbrojtjen, në këtë fazë do të mund të çonte në zbulimin e identitetit të familjarëve të tij për të akuzuarin dhe Mbrojtjen, para se ata të kenë mundësinë të shprehen në lidhje me masa mbrojtëse të domosdoshme.

34. Për këto arsye, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vlerëson se nxjerrja për publikun, të akuzuarin dhe Mbrojtjen i materialit ose i informacionit që mund të çojë në identifikimin e parashtruesit të kërkesës, përbën rrezik objektivisht të arsyeshëm për të, dhe në veçanti, për familjarët e tij. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se anonimiteti i parashikuar në rregullën 80(4)(e)(i) të Rregullores është masa më e përshtatshme dhe e domosdoshme në këtë fazë të procesit.

³⁰ KSC-BC-2020-04, F00008, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Lëshimin e Fletarrestimit dhe Urdhrit të Transferimit*, 12 qershor 2020, konfidencial, para. 21-22. Versioni i redaktuar publik i lëshua më 6 maj 2021, F00008/RED; Vendimi mbi Lirimin e Përkohshëm, para. 32-33, 35, 39-40; para. 33, 35, 39.

³¹ *Shih* Vendimi i Parë për Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 37; *Ngjashëm ICC, Prosecutor v. Lubanga*, ICC-01/04-01/06-1119, Trial Chamber I, [Decision on Victims' Participation](#), 18 January 2008, para. 128.

³² Viktima 02/04, Formulari i Kërkesës, f. 2.

³³ Raporti i Dytë i Zyrës Administrative, para. 10.

35. Në lidhje me proporcionalitetin e masës, Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se çdo masë mbrojtëse e urdhëruar në këtë fazë në lidhje me një viktimë të pranuar nuk pengon ndryshimin e asaj mase në ndonjë fazë të mëvonshme, përfshirë edhe nga Trupi Gjykses, nëse lind nevoja dhe kur të lindë kjo nevojë.³⁴ Bazuar në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se anonimitetit sipas rregullës 80(4)(e)(i) të Rregullores është masë proporcionale në këtë fazë të procesit.

36. Duke pasur parasysh sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se masat në vijim janë të përshtatshme, të domosdoshme dhe proporcionale në këtë fazë të procesit, konkretisht: (i) redaktimi i emrit dhe informacionit identifikues të parashtruesit të kërkesës nga dokumentacioni publik i DHS-së (rregulla 80(4)(a)(i) e Rregullores); (ii) mosnxjerrja për publikun e dokumentacionit që identifikon parashtruesin e kërkesës (rregulla 80(4)(a)(ii) e Rregullores); (iii) caktimi i pseudonimit (rregulla 80(4)(a)(vi) e Rregullores); (iv) mosnxjerrja për të akuzuarin dhe Mbrojtjen i informacionit që mund të çojë në zbulimin e identitetit të parashtruesit të kërkesës (rregulla 80(4)(d) e Rregullores); dhe (v) mosnxjerrja për Mbrojtjen e materialit ose informacionit që mund të çojë në zbulimin e identitetit të parashtruesit të kërkesës (rregulla 80(4)(e)(i) e Rregullores).

37. Megjithatë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se parashtruesi i kërkesës kërkoi anonimitet në lidhje me publikun.³⁵ Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e gjykon të përshtatshme të urdhërojë përkohësisht masa mbrojtëse në bazë të rregullës 80(4)(d) dhe (e)(i) të Rregullores. Kur të emërohet mbrojtësi i viktimave dhe në përputhje me konstatimet e mëposhtme si dhe pas konsultimit me

³⁴ *Shih gjithashtu* Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave , para. 39.

³⁵ Shtojca e Raportit të Dytë të Zyrës Administrative, f. 3; Viktima 02/04, Formulari i Kërkesës, f. 2.

parashtruesin e kërkesës, ai të dorëzojë parashtrime, jo më vonë se të **premtën, 7 tetor 2022**, lidhur me vijimin e zbatimit të këtyre masave.

38. Së fundi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se, në përputhje me rregullën 113(1) të Rregullores, të gjithë formularët e kërkesës, përmbledhjet dhe dokumentacioni mbështetës mbeten rreptësisht konfidencial *ex parte*.

C. GRUPIMI DHE PËRFAQËSIMI JURIDIK I PËRBASHKËT

39. ZPV-ja rekomandon që parashtruesi i kërkesës të grupohet së bashku me viktimat e tjera pjesëmarrëse në proces dhe që ata të përfaqësohen nga mbrojtësi i Viktimave i caktuar.³⁶

40. Bazuar në të njëjtat arsyetime si në Vendimin Kornizë,³⁷ Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se parashtruesi i kërkesës, i cili nuk ka shprehur parapëlqim,³⁸ grupohet së bashku me viktimën 01/04, e pranuar në Vendimin e Parë për Pjesëmarrjen e Viktimave.³⁹ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se parashtruesi i kërkesës pësoi dëm prej krimeve të ngjashme të pretenduara nga viktimja 01/04 dhe duket se të dy kanë interes të përbashkët për të marrë pjesë në proces dhe për të kërkuar të drejtat e tyre. Rrjedhimisht, ata përfaqësohen si një grup i viktimave pjesëmarrëse në proces (“Grupi 1”).

41. Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu konstaton se Grupi 1, përfshirë viktimën, përfaqësohet prej mbrojtësit të viktimave që u caktua më parë për përfaqësim të viktimës 01/04.

³⁶ Raporti i Dytë i Zyrës Administrative, para. 34, 36.

³⁷ Vendimi Kornizë, para. 49.

³⁸ Raporti i Dytë i Zyrës Administrative, para. 35.

³⁹ Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 35, 50(a).

D. PJESËMARRJA NË PROCEDURËN PARAPRAKE

42. Viktima 02/04 përmes mbrojtësin të viktimave ushtron të drejtën e vet dhe merr pjesë përmes modaliteteve të përshkruara në Vendimin e Parë për Pjesëmarrjen e Viktimave.⁴⁰

V. VENDIM

43. Bazuar në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake :

- (a) **URDHËRON** ZPV-në të dorëzojë kopjen e shënimit në dosje përmendur në Shtojcën e Raportit të Dytë të Zyrës Administrative jo më vonë se **të premten, 19 gusht 2022;**
- (b) **MIRATON** kërkesën e parashtruesit të kërkesës dhe e pranon parashtruesin e kërkesës si viktimë pjesëmarrëse në proces;
- (c) **VENDOS** që parashtruesi i kërkesës dhe viktima 01/04 të përfaqësohen si Grupi 1;
- (d) **VENDOS** që Grupi 1 të përfaqësohet prej mbrojtësit të viktimave të caktuar më parë për viktimën 01/04;
- (e) **VENDOS** që mbrojtësi i viktimave:
 - (i) të ketë qasje në dosjen e plotë të çështjes, përfshirë në të gjitha parashtrime publike dhe konfidenciale, transkripte dhe material provues dhe me përjashtim të dokumenteve *ex parte* dosjes së çështjes;
 - (ii) të njoftohet për të gjitha dokumentet e shpërndara që i përkasin dosjes së çështjes, përfshirë të gjitha parashtrimet e protokolluara publike dhe konfidenciale, transkripte dhe material provues dhe me përjashtim të dokumenteve *ex parte* dosjes së çështjes;
 - (iii) të mos ketë qasje dhe as të mos njoftohet për material rreptësisht konfidencial, përfshirë parashtrime të protokolluara, transkripte dhe

⁴⁰ Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 47-49, 50(c).

- material provues, përveç nëse i jepen konkretisht;
- (iv) t'i informojë viktimat pjesëmarrëse për zhvillime përkatëse në çështjen gjyqësore në një mënyrë që nuk zbulon informacione jopublike;
- (v) të jetë i pranishëm në të gjitha seancat e procedurës paraprake, me përjashtim të seancave *ex parte*; dhe
- (vi) t'i lejohet të bëjë parashtrime gojore dhe me shkrim, pa kërkuar leje paraprakisht, kurdoherë që të preken viktimat pjesëmarrëse në proces;
- (f) **URDHËRON** masat mbrojtëse për parashtruesin e kërkesës sikurse saktësohet në paragrafin 36 më lart;
- (g) **URDHËRON** mbrojtësin e viktimave të dorëzojë parashtrime në lidhje me domosdoshmërinë e vijimit të zbatimit të masave mbrojtëse të urdhëruara në bazë të rregullës 80(4)(d) dhe (e)(i) të Rregullores jo më vonë se **të premten, 7 tetor 2022**; dhe
- (h) **VENDOS** të ruajë klasifikimin rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* të të gjithë formularëve kërkesë, përmbledhjeve dhe dokumentacionit mbështetës.

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju
Gjykatës i Procedurës Paraprake

E enjte, 11 gusht 2022

Hagë, Holandë.